



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 125/2013
Prishtinë, më 03.12.2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti- kryetar, Teuta Sahatqija, zëvendëskryetare, Fikrim Damka, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Etem Arifi - anëtarë.

Munguan: Hashim Deshishku dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Dardan Abazi – INDEP dhe Amire Qamili, gazetarë – KosovaPress.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit dhe një pjesë Fikrim Damka, zëvendëskryetar i dytë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.11.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike;
4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime të Projektligjit nr. 04/L-220, për investimet e huaja;
5. Të ndryshme.

Në mungesë të kryetarit të Komisioni në fillim të mbledhjes, atë e zëvendësoi Fikrim Damka, zëvendëskryetar i dytë i Komisionit.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.11.2013

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.11.2013, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike

Kryesuesi – Grupi i punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe stafi i Komisionit, e kanë hartuar një draft-raport me rekomandime. Më pas, fjalën ia dha z. Shaip Muja, kryesues i grupit të punës, për të paraqitur Raportin me rekomandime.

Shaip Muja – Fillimisht, falënderoi stafin e Komisionit dhe përfaqësuesin e organizatës INDEP, që gjatë monitorimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, kanë bërë një punë të shkëlqyeshme. Ai tha se grupi i punës e ka zhvilluar aktivitetin e mbikëqyrjes së Ligjit për Ndërmarrjet Publike, në bazë të Planit të veprimit dhe agjendës së miratuar. Pastaj, ai e paraqiti në mënyre kronologjike aktivitetin e grupit të punës, pra për punën që e ka bërë. Më tutje, theksoi se ka pasur disa takime ku i ka ftuar të gjitha palët që janë të obliguar për ta zbatuar ligjin në fjalë, duke filluar nga përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik- Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike dhe të gjithë përfaqësuesit e ndërmarrjeve publike qendrore dhe lokale, si dhe përfaqësuesin e Asociacionit të Komunave të Kosovës. Po ashtu, e ka pasur vizitë edhe në Qeverinë e Kosovës, me sekretarin e përgjithshëm të Qeverisë. Komisioni ka organizuar një dëgjimi publik ku janë ftuar të gjitha palët që kanë të bëjnë me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe shoqërinë civile, dhe në fund, është ftuar z.Fadil Ismajli, ministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, për raportim në Komision. Më tutje, theksoi se gjatë gjithë këtyre takimeve dhe dëgjimit publik, janë paraqitur të arriturat, sfidat dhe problemet që po ballafaqohen gjatë zbatimit në praktik të Ligjit për Ndërmarrjet publike. Në fund, tha se grupi i punës ka nxjerrë tetë (8) rekomandime, duke u bazuar në të gjeturat faktike gjatë monitorimit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ku i paraqiti si në vijim:

Rekomandime

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, të përfshijë në Strategjinë Legjislative për vitin 2014, plotësimin- ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.
2. Qeveria të marrë masa që bordet, të cilat kanë shkëlur detyrat e tyre apo që janë vlerësuar me notë të dobët nga NJPMNP, të shkarkohen nga detyra.
3. Qeveria t'u kthejë përgjigje komunave, në lidhje me kërkesat e tyre për themelimin të ndërmarrjeve publike.
4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik të fuqizojë rolin e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, në aspektin e mbikëqyrjes së ndërmarrjeve publike, si dhe në aspektin e ngritjes së kapaciteteve administrative dhe financiare.

5. Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve, duhet të evaluojë jo nga ndërmarrja publike, por nga ndonjë mekanizëm tjetër i kontraktuar nga jashtë ndërmarrjes.
6. Konkursët për drejtorë të ndërmarrjeve publike, të jenë në përputhje me ligjin në fuqi dhe të pasqyrojnë domosdoshmërinë e karakterit jopolitik të bordeve të ndërmarrjeve publike.
7. Bordet e ndërmarrjeve rajonale duhet të rriten në atë mënyrë që t'u mundësohet komunave të atij rajoni të caktuar, pjesëmarrje në bordet e këtyre ndërmarrjeve.
8. Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, në raportet e performancës së bordeve, të përfshijë edhe rekomandimet për Qeverinë e Kosovës sesi të veprohet me bordet, të cilat nuk kanë performuar mirë.

Myzejene Selmani – Tha se rekomandimi i parë, duhet të zhvendoset si rekomandim i fundit, sepse duhet të paraqiten të gjitha rekomandimet, e mandej t'i rekomandohet Qeverisë për të ndryshuar dhe plotësuar ligjin. Rekomandimi nr. 2, duhet të plotësohet dhe të përputhet me kërkesat e ligjit. Rekomandimi nr. 6, aty ku flitet për konkursët për drejtorë të bordeve, duhet të cekët qartë se kandidatët nuk duhet të jenë individ nga partitë politike. Ndërsa, për rekomandimin nr. 7, tek ndërmarrjet rajonale, tha se pajtohet se duhet të rriten, mirëpo jo në atë masë, sepse mund të ketë kosto të lartë financiare. Në fund, propozoi edhe një rekomandim shtesë, me këtë përmbajtje: “Ndërmarrjeve publike duhet t'u bëhet auditimi i jashtëm nga një auditor i jashtëm i pavarur”.

Sala Berisha- Shala – Tha se rekomandimi i parë, ku thuhet: “Qeveria e Republikës së Kosovës, të përfshijë në Strategjinë Legjislative për vitin 2014, plotësim - ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike”, duhet të mbetet, sepse është çelësi i të gjitha rekomandimeve të tjera, mirëpo propozoi që do të duhej të cekën se cilat janë ndryshimet që duhet të bëhen në ligj. Po ashtu, edhe rekomandimi nr. 5, është baza që kemi vërejtur gjatë këtij monitorimit, sepse njëherë e përgjithmonë duhet të gjendet një mekanizëm tjetër i kontraktuar nga jashtë ndërmarrja publike, që të konstatojë nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve. Ndërsa, te rekomandimi nr. 6, propozoi që fjala “jopolitik”, të zëvendësohet me fjalën “profesional”, sepse duhet të marrim parasysh se kjo ka qenë fryma e ligjit, që bordet të jenë të përbëra me anëtarë të nivelit profesional e jopolitik.

Visar Ymeri – Pajtohet në parim me këto rekomandime, mirëpo propozoi që të ndahen në dy pjesë: në rekomandimet që kanë të bëjnë me vetë ligjin dhe të cekën aty se cilat janë dispozitat të cilat janë të pa zbatueshme dhe pjesa tjetër e rekomandimeve që kanë të bëjnë me funksionimin e institucioneve, që janë përgjegjëse për zbatimin e Ligjit, siç është në këtë rast Njësia për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike. Ai tha se pajtohet edhe me përmbajtjen e rekomandimit nr. 5, që përket gjetjes për të matur nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve të ndonjë mekanizmi tjetër jashtë ndërmarrjes, por kërkoi që të riformulohet. Ai propozoi që të ketë edhe një rekomandim shtesë, në lidhje me kriteret për rimbursimin dhe kompensimin e bordeve dhe menaxhmentit të lartë.

Lutfi Zharku – Tha se pajtohet në parim me rekomandimet, mirëpo propozoi që rekomandimi nr. 2 dhe nr. 8, të fuzionohen me këtë përmbajtje: “Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, në raportet e performancës së bordeve, t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës, që të marrë masa për bordet, të cilat nuk kanë performuar mirë”. Mandej, ai tha se te rekomandimi nr. 6, pajtohet që fjala “jopolitik”, të zëvendësohet me fjalën “profesional”. Ndërsa, te Rekomandimi nr. 7, tha se pajtohet që duhet të rritet numri i

ndërmarrjeve publike nëpër rajone, mirëpo tha se mund të kemi mos efikasitet në funksionimin e tyre. Ai u pajtua me z. Ymeri, që të shtohet një rekomandim i ri me këtë përmbajtje: “Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, të hartojë udhëzime të qarta për bordet, mbi mënyrën e kompensimit dhe rimbursimit të menaxhmentit të lartë të një ndërmarrje publike”.

Kryetari – Pas këtyre diskutimeve, kemi disa propozime që rekomandimi nr. 2 dhe nr. 8, të fuzionohen dhe të shtohen dy rekomandime të reja si ai i znj. Selmani, lidhur me auditimin e jashtëm dhe ai i z. Zharku dhe z. Ymeri, lidhur me çështjen e rimbursimit dhe kompensimit. Propozoi që të rekomandimi nr. 7, fjala “ rriten”, të zëvendësohet me “ organizohen”.

Shaip Muja – Tha se pajtohet me debatin dhe me vërejtjet e paraqitura, si dhe me propozimet e reja, mirëpo theksoi se nuk kemi nevojë që rekomandimin nr. 1, lidhur me ndryshimin e ligjit, ta zgjerojmë, sepse tek pika e pestë e raportit, pra tek “Zbatueshmëria e ligjit”, janë të cekura dispozitat që nuk kanë zbatim të plotë të këtij ligji, si dhe sfidat të cilat paraqiten tek institucionet që janë të obliguara për zbatimin e këtij ligji. Ndërsa, sa i përket rekomandimit nr. 5, tha se është mjaft i qartë dhe se nuk ka nevojë të ndryshohet. Dhe, sa i përket shtimit të një rekomandimi të ri, lidhur me auditimin e jashtëm, tha se nuk ka nevojë, për shkak se ligji është i qartë në këtë aspekt dhe iu lejohe ndërmarrjeve publike që të bëjnë auditimin e jashtëm. U pajtua që rekomandimi nr. 2, dhe nr. 8, të fuzionohen, si dhe të shtohet një rekomandim i ri, lidhur me çështjen e rimbursimit dhe kompensimit. Po ashtu, fjala “ Jopolitik” të rekomandimi nr. 6, të zëvendësohet me “profesional”, si dhe të rekomandimi nr. 7, fjala “rriten”, të zëvendësohet me “organizohen”.

Pas debatit, Komisionit nxori këto

R e k o m a n d i m e:

- 1. Qeveria e Republikës së Kosovës, të përfshijë në Strategjinë Legjislative për vitin 2014, plotësimin- ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike.*
- 2. Qeveria t’u kthejë përgjigje komunave, në lidhje me kërkesat e tyre për themelimin e ndërmarrjeve publike.*
- 3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik të fuqizojë rolin e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, në aspektin e mbikëqyrjes së ndërmarrjeve publike, si dhe në aspektin e ngritjes së kapaciteteve administrative dhe financiare.*
- 4. Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve, duhet të evalulojë jo nga ndërmarrja publike, por nga ndonjë mekanizëm tjetër i kontraktuar nga jashtë ndërmarrjes.*
- 5. Konkursët për drejtorë të ndërmarrjeve publike, të jenë në përputhje me ligjin në fuqi dhe të pasqyrojnë domosdoshmërinë e karakterit profesional të bordeve të ndërmarrjeve publike.*
- 6. Bordet e ndërmarrjeve rajonale duhet të organizohen në atë mënyrë që t’u mundësohet komunave të atij rajoni të caktuar pjesëmarrje në bordet e këtyre ndërmarrjeve.*

7. *Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, në raportet e performancës së bordeve, t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës, që të marrë masa për bordet, të cilat nuk kanë performuar mirë.*
8. *Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike të hartoj udhëzime të qarta për Bordet mbi mënyrën e kompensimit dhe rimbursimit të menaxhmentit të lartë të një ndërmarrje publike.*

4. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-220 për investimet e huaja

Kryetari – Pasi që të gjitha komisionet e përhershme i kanë shqyrtuar amendamentet e Komisionit Funkcional dhe nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje, atëherë sipas procedurave të Rregullores së punës së Kuvendit, duhet të procedohet për në seancë plenare për shqyrtim në lexim të dytë.

Komisioni, me 7 (shtatë) vota për dhe 1 (një) votë kundër, nxori këtë

Përfundim

1. *Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 04/L-220 për investimet e huaja.*
2. *Raporti t'i procedohet seancës plenare, sipas procedurës.*

5. Të ndryshme **Çështjet vijuese**

Kryetari – I njoftoi deputetët se e kemi një ftesë për takim, lidhur me rezervat shtetërore të mallrave me Sekretariatit e Energjisë, me seli në Vjenë. Takimi do të mbahet nesër.

Teuta Sahatqija – Kërkoj nga kryetari që t'i dërgohet një shkresë Qeverisë, që t'i nominojë anëtarët e rinj për Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sepse ajo agjenci ka mbetur e bllokuar, për shkak se nuk ka bord funksional, dhe për këtë arsye, s'po shpërndahen mjetet e 20% për punëtorët e ndërmarrjeve të shitura.

Kryetari – Si Komision, e kemi njoftuar Qeverinë, po ashtu edhe me rekomandimin lidhur me raportin vjetor të AKP-së, por këtë raport e ka bllokuar Komisioni funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Lidhur me këtë, kam kërkuar nga Kryesia e Kuvendit, që të bëjë procedimin e këtij raporti, sa më shpejt që është e mundur, për shqyrtim në seancë plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti